



# **UDHËZUES PËR GAZETARËT**

**PËR EDUKIMIN NË FUSHËN  
E MEDIAS DHE INFORMACIONIT**

Dr. Radmila Rangelov Jusović dhe Nedim Krajišnik



# **UDHËZUES PËR GAZETARËT**

## **PËR EDUKIMIN NË FUSHËN E MEDIAS DHE INFORMACIONIT**

Dr. Radmila Rangelov Jusović dhe Nedim Krajišnik

GAZETARË DHE GAZETARE PËR FËMIJË	5
ÇFARË DUHET DITUR RRETH ASAJ SESI MËSOJNË FËMIJËT	6
PARA SE TË FILLONI	7
FAZA E PARË – HYRJE NË TEMË	8
IDE PËR TË FILLUAR	8
Çfarë bëjnë gazetarët/gazetaret?	9
Si janë gazetarët/gazetaret?	9
PJESA KRYESORE	10
Redaksia e shkollës	10
Si formohet lajmi?	11
Shkruajeni vetë lajmin tuaj	12
Përmirësojeni lajmin tuaj	12
Përse faktet janë të rëndësishëm?	13
Koha e informacioneve të pasakta dhe të gënjeshtërt (për nxënës të rritur)	14
Intervista	15
Lojë me pyetjet	15
Pyetje për intervistë:	16
PËRFUNDIMI I VEPRIMTARISË	17
KODI I ETIKËS SË GAZETARIT: NJË PËRMBLEDHJE	18
Rreth autorëve	21

# GAZETARË DHE GAZETARE PËR FËMIJË

Profesioni i gazetarisë dhe i mësimdhënies kanë shumë pika kontakti. Si mësuesit edhe gazetarët kanë një publik të cilit i drejtohen, një publik që duhet informuar, edukuar, të nxitet të mendojë, duke përfshirë emocionet, duke ngjallur empati, por edhe duke zbavitur e argëtuar. Pavarësisht se janë dy profesione, ato në të njëjtën kohë janë edhe një vokacion, i cili nuk mund të kryhet pa iu kushtuar tërësisht, pa pasion, pa studim të vazhdueshëm dhe të investohet personalisht. Si gazetarët ashtu edhe mësuesit nuk dalin asnjëherë jashtë rolit të tyre – ata e përjetojnë atë përgjatë 24 orëve të ditës, 12 muajve të vitit.

Po kështu gazetarët dhe fëmijët kanë shumë gjëra të përbashkëta – pasionin për të hulumtuar, interesimin për njerëzit e tjerë dhe ngjarjet, fantazinë e nxitjen e shpirtit të aventurës. Mjeshtëria e aftësitë e nevojshme për t'u bërë një gazetar i mirë zhvillohen qysh në fëmijërinë e herët. Dëshira për të lexuar dhe aftësia e

analizës së leximit, mjeshtëritë që lidhen me të shkruarit, zhvillimi i aftësisë për të menduar me kokën tënde, argumentimi, zotësia për të bërë pyetje të mira janë vetëm disa syresh. Gazetarët e mirë krijohen në shkollën fillore me ndihmën e mësuesve të zotë.

Në publik dhe midis fëmijëve ekzistojnë qëndrime dhe besime të ndryshme që lidhen me gazetarët dhe vokacionin për t'u bërë gazetar. Disa prej tyre janë pozitivë, ndërsa disa të tjerë nuk janë. E megjithatë mediat janë pjesë e pandarë e jetës sonë, ndërsa gazetaria një profesion që ushtron ndikim të madh mbi atë çka mendojmë, jetojmë dhe bëjmë. Pikërisht për këtë gjë është mëse e rëndësishme që qasjen gazetareske ndaj fëmijëve ta bëjmë në mënyrën e duhur. Synimi është që këtë gjë ta bëjmë me qasjen më të mirë, më interesante, por edhe kritike ndaj mediave të ndryshme, duke pasur parasysh se disa prej syresh do të dëshirojnë që gazetaria të jetë vokacioni i tyre i ardhshëm.

# ÇFARË DUHET DITUR RRETH ASAJ SE SI MËSOJNË FËMIJËT

Të nxënë të fëmijëve është një mjeshtëri jo e thjeshtë për t'u zotëruar. Sa për fillim është e rëndësishme të ngulitni në kujtesë se të nxënë të nuk është grumbullimi i fakteve të shumta me pritshmëri që fëmijët do t'i bëjnë të tyret dhe do t'i mbajnë mend. Të mësuarit është një sfidë dhe një aventurë emocionuese zbulimi hapësirash të panjohura së cilës duhet

t'i gëzoheni edhe ju bashkë me fëmijët. Ora juaj e mësimit mund të organizohet pikërisht kështu, duke ngjallur te nxënësi kureshtjen për ta përfshirë maksimalisht në të gjithë proceset. Numri i strategjive që mund t'ju shërbejnë është i madh, ndaj shpresojmë se në këtë udhëzues të shkurtër do të gjeni ide që mund t'ju vijnë në ndihmë dhe do të mund t'ju frymëzojnë.



## Para së gjithash, ja disa vëzhgime rreth mënyrave sesi fëmijët mësojnë:

- Fëmijët mësojnë më mirë kur përfshihen në mënyrë aktive në procesin e të mësuarit dhe kur e krijojnë ata vet një koncept të të kuptuarit të gjërave – *Mos më thuaj, por më udhëhiq që të mbërrij vetë në atë përfundim.*
- Fëmijët mësojnë më mirë atëherë kur përmbajtja është kuptimplotë për ta dhe e lidhur me „jetën reale“ dhe përvojat e tyre – *Më pyet nëse më ka ndodhur mua personalisht diçka e ngjashme; më ndihmo ta kuptoj se ku mund të shkoj e ta gjej këtë dije?*
- Të mësuarit është edhe më efikas kur fëmijët ndjehen të sigurt dhe atëherë kur idetë e tyre vlerësohen dhe bëhen të vlefshme – *Më pyet se çfarë mendoj; më dëgjo dhe vrite mendjen për atë që them; mos më nënvleftëso, por as më mbivleftëso.*
- Fëmijët kanë nevojë për mësues të përkushtuar dhe entuziastë – *Më jep të kuptoj që edhe për ty është e rëndësishme kjo që thua dhe që bën!*

Secilën prej veprimtarive të propozuara mund ta organizoni në mënyrë të atillë që nxënësit të punojnë, bisedojnë dhe/ose t'i zgjidhin detyrat në çift ose në grupe të vegjël. Kjo gjë do t'u japë mundësi të marrin pjesë aktive dhe të ndajnë me të tjerët përvojat dhe dijet e tyre.

Kushtojini vëmendje kohës! Do ta keni të pamundur të organizoni të gjitha veprimtaritë e planifikuara; kjo do të varet nga përzgjedhja juaj, grupmosha e fëmijëve, si dhe interesi juaj ose i tyre.

Kur keni ndër mend të përdorni Power Point në slide vendosni vetëm fjalët kyç për atë çka synoni të flisni dhe jo tekstin e plotë. Shkronjat e mëdha, fotografitë dhe vizatimet do ta bëjnë prezantimin tuaj të „lexueshëm“, të këndshëm dhe interesant.

Gjatë diskutimit ose prezantimit iu kërkoni nxënësve t'ua bëjnë me shenjë kur duan të flasin dhe bëni kujdes t'i thërrisni me radhë, si dhe ta keni krejt klasën parasysh. Fëmijëve ua ka ënda kur i trajtoni njëlloj të gjithë. Herë pas here kontaktoni me shikim ata fëmijë që nuk shfaqin interes dhe pyetini se çfarë mendojnë. Disa prej fëmijëve, ndryshe nga të tjerët, ndihen më të sigurtë e të hapur, por mos i lejonin ata që të mbizotërojnë diskutimin.

Përzgjidhni me kujdes shembujt nga teksti, lajmet dhe punimet e tjera gazetareske. Kini parasysh se keni të bëni me fëmijë dhe ndonjë prej tyre nuk i kupton konceptet ose mund t'i interpretojë në mënyrë të gabuar. Këtu bëhet fjalë veçanërisht për tekste që kanë sfond politik ose fetar, të cilët iu drejtohen dhe flasin për grupe të caktuar. Gjeni ata shembuj që iu shkojnë për shtat grupmoshave dhe mundësive të tyre.

# PARA SE TË FILLONI

Mos e nënvleftësoni përgatitjen për të bërë një punë sa më të mirë me fëmijët. Ata janë një publik mjaft mirënjohës, por edhe kërkues – varet nga rezultatet që kërkoni të arrini. Kështu që, para se të hyni në klasë dhe të takoheni me fëmijët, duhet ta keni të qartë jo vetëm atë që keni ndër mend të bëni ose të thoni, por edhe

atë çka synoni që fëmijët të pajisen nga ky proces. Efikasiteti dhe cilësia e mësimdhënies nuk maten me sasinë e përmbajtjes që është „përcjellë” apo me faktin se sa zbavitës ishte, por me faktin se sa ka ndikuar puna juaj me fëmijët për të përfutur ndryshime të qëndrueshme në mendimet, dijet dhe talentin e tyre.



## Mund të shtroni pyetjet:

Çfarë është e rëndësishme t’u përcjell fëmijëve lidhur me vokacionin tim – çfarë më ka tërhequr mua te ky profesion dhe pse?

Çfarë informacionesh të rëndësishme në kuadër të kësaj teme mund të zbulojnë, përfitojnë dhe kuptojnë nxënësit?

Përse këto tema mund të jenë të rëndësishme për nxënësit: si mund t’i lidh me jetën time?

Si mund të zgjoj kureshtjen dhe interesimin e tyre për këtë temë?

Cila është ajo përmbajtje dhe çfarë mund të bëj që të zgjoj reagimet dhe motivimet personale të nxënësve?

Si mund t’i aktivizoj – jo vetëm fizikisht, por edhe mendërisht? Si mund t’i nxis të mendojnë, të arrijnë në përfundime, të shtrojnë pyetje, hulumtojnë?

# FAZA E PARË - HYRJE NË TEMË

Faza e parë e të mësuarit i ngjan shkrimit të titullit dhe paragrafit të parë të tekstit. Kjo është gjëja më e rëndësishme dhe shpesh rasti i vetëm për ta tërhequr lexuesin dhe nxitur ta lexojë krejt tekstin. Në këtë fazë, lexuesit, me fjalë të tjera nxënësit, orvaten të zbulojnë se për çfarë

bëhet fjalë, të lidhë të renë me të njohurën, teksa në kokë iu shfaqen një sërë pyetjesh që kërkojnë përgjigje. E më e rëndësishmja këtu ata vendosin nëse „leximi“ ka edhe më tej kuptim e qëllim për ta.

## IDE PËR TË FILLUAR

Të gjithë ne mësojmë më mirë atëherë kur iu japim përgjigje pyetjeve që na lindin në kokë, ndjekim atë që na intereson dhe kur njohuritë e reja i lidhim me përvojat dhe dijet vetjake. Pikërisht për këtë gjë është e nevojshme që mësimi të fillojë prej përvojës së vetë nxënësit, prej atyre që ata tanimë i dinë ose mendojnë që i dinë lidhur me gazetarinë.

Pas parashtrimit mund t'ia nisni duke bërë ndonjë pyetje të thjeshtë: „Po, jam gazetar/gazetare – por si mendoni çfarë do të thotë kjo gjë, çfarë bëjnë në realitet?“ ose „Si mendoni ju, për ç'arsye ekziston gazetaria si profesion?“ Jepuni një ose dy minuta kohë ta vrasin mendjen dhe shpjegojani sepse fëmijët nuk funksionojnë „me sustë“.

Jepuni mundësi të thonë çfarë mendojnë, pa ua prerë fjalën. Edhe sikur komunikimi të jetë i vështirë bëjini vetes pyetjet: ku është vendi im i punës, me kë ka të bëjë e gjithë kjo, cili është rezultati i punës sime?

Kërkoni që ta vrasin mendjen për ditën dhe të mendojnë se po kryejnë diçka me të cilën merren gazetarët – lajme, portale, gazeta, emisione dokumentarë, intervista... Verifikoni nëse dhe çfarë nga puna e gazetarit ata lexojnë ose dëgjojnë. Çfarë mendojnë për këtë gjë?

Pyetja që lind është, çfarë konsumojnë fëmijët nga mediat ekzistuese – dhe nëse ajo çka lexojnë është fryt i punës së gazetarëve ose i autorëve të tjerë? Kush janë ata dhe nëse iu besojnë?



## Çfarë bëjnë gazetarët/gazetaret?

Në format letre A4 shkruani forma të ndryshme gazetarie dhe jepuni fëmijëve në grupe (ose në qoftë se ulen në tri radhë bankash, një çift mund të ulet nga pas dhe të formojnë një grup të vogël) që të tërheqin njëren fije të

letrës. Në fjet e letrës mund të gjenden punët gazetareske si këtu më poshtë, të cilat mund t'i ndreqni edhe vetë, t'i shtoni ose t'i hiqni si t'ju vijë juve më mbarë:



- Gazetar i programit të informacionit
- Gazetar i rubrikës zbavitëse
- Gazetar i redaksisë sportive
- Gazetar editorialist
- Gazetar i radios
- Gazetar i TV
- Gazetar i gazetarisë investigative
- Gazetar në media online

Në letër shkruani (dhe/ose shjegojuani me gojë) detyrën: Përfytyroni sikur e keni fituar një vend për të bërë punët e mësipërme – si mendoni se duhet të veproni për ta kryer atë? Përse këto punë janë të rëndësishme për një gazetar/gazetare? Nga se dallon puna e gazetarit nga ajo e spikerit/es fjala vjen në emisionin e lajmeve?

Jepuni kohën e duhur që grupet e punës të hartojnë listat e punëve dhe t'i prezantojnë. Orientojeni diskutimin duke bërë pyetje, duke iu kërkuar nxënësve të tjerë të shprehin mendimet e tyre dhe, në fund, mund të shpjegoni rolin e gazetarit ose të gazetares në kryerjen e punës së vet.

## Si janë gazetarët/gazetaret?

Shumojini letrat me figurën e një personi.

Lutjuni nxënësve që në çift të shkruajnë në fijen e letrës:



- Koka – çfarë duhet të dijë një gazetar?
- Duar – çfarë duhet për të qenë gazetar, çfarë aftësish duhet të ketë?
- Te zemra – ç'lloj njerëzish duhet të jenë gazetarët?
- Çfarë tiparesh duhet të kenë?



Kërkojuni që me radhë të prezantojnë atë që kanë shkruar. Kërkojuni të shpjegojnë se përse është e rëndësishme? Çfarë mësojnë gazetarët

në fakultet dhe si quhet fakulteti i tyre? Paraqituni degën e Gazetarisë.

# PJESA KRYESORE

Përsëri, ashtu si me një artikull gazete, mbasi e keni bërë për vete lexuesin me paragrafin hyrës, qëllimi është që ai ta lexojë deri në fund. Në fazën e dytë puna me fëmijët duhet t'iu ofrojë atyre veprimtari që i pajisin me njohuri të reja dhe i ballafaqojnë me informacione të reja, të

panjohura. Kjo është koha e të mësuarit, e cila zhvillohet në mënyrë që fëmijët të përpiqen e të bëjnë diçka të re, ta ndjekin hap pas hapi punën në rrjedhën e vet, duke qenë të aftë të arsyetojnë vetë.

## Redaksia e shkollës

Jepuni të kuptojnë nxënësve se tani janë ata vetë redaksia e revistës së tyre (më parë sigurohuni që fëmijët e dinë se ç'është thotë redaksi, kush është roli i redaktorit në redaksi, çfarë bëjnë korrektorët, fotografi... ). Pyetini sesi mund të jetë revista e tyre, si mund të quhet...

Pas një shkëmbimi të shkurtër idesh, kërkoni prej tyre t'ju ndihmojnë të plotësoni tabelën: Sqaroni se artikujt gazetareskë mund të kenë qëllime dhe funksione të ndryshme, por më së shumti shkruhen që të na:



I – informojnë (përcjellin lajme, të ofrojnë fakte e të dhëna, të vënë në dijeni lidhur me diçka... ).

Z – zbavisin (ofrojnë kuriozitete, na bëjnë për të qeshur, na argëtojnë... ).

B – bindin për diçka (ndikojnë në atë që ta vrasim mendjen për diçka, të ndryshojmë mendim, të veprojmë... ).

Shtyjini të mendojnë dhe t'ju ofrojnë, si në redaksi të vërtetë, propozime për artikuj që mund të botohen për revistën e tyre. Për

çfarë të shkruajnë? Me çfarë të merren? Çfarë artikujsh do t'ua kishte ënda të gjenin për veten e tyre në revistat ose gazetatat lokale?

Lloji i tekstit	Ide për artikull/shkrime për t'u vendosur në revistë:
I - Informojnë	
Z - zbavisin	
B - bindin për diçka	

# Si formohet lajmi?

Në mënyrë që fëmija ta përvetësojë logjikën e lajmit përzgjidhni një lajm të shkurtër dhe copëzoheni në pjesë, duke pasur parasysh që

çdo pjesë të përkojë me një tërësi prej këtyre pesë ose gjashtë pyetjeve kyç: kush, çfarë, ku, kur, si, pse. Printojini veç e veç çdonjërin prej pyetjeve.



**Çfarë** (ndodhi)?

**Kush** (është përfshirë)?

**Ku** (ndodhi)?

**Kur** (ndodhi – ora dhe data)?

**Pse** (ndodhi – arsye)?

**Si** (ndodhi – lidhjet)?

Fillimisht kërkoni nga fëmijët që prej pjesës që iu janë ofruar të formojnë lajmin ashtu siç dinë ta shkruajnë, e më pas të shpjegojnë për ç'arsye e konceptojnë ashtu. Kanë punuar të gjithë njëllë? Pse është e rëndësishme?

Jepuni letrat me pyetje dhe kërkoni të bëjnë lidhjen e pjesëve të lajmit me pyetjet që i përgjigjen asaj pjesë të tekstit.

Për shembull (pjesë të lajmit):

- Golat i shënuan Osmanoviç dhe Periç
- Fitoi me rezultatin 3 – 1
- Gjatë takimit të kthimit
- Ekipi i futbollit Qendra

- Ekipi i gjimnazit
- Kjo ishte fitorja e parë e skuadrës vendase
- Në stadium në Visoko
- Të shtunën e kaluar, 12.05.2019 në orën 17.00

Teksti i shkrimit mund të jetë ky:

Gjatë ndeshjes së kthimit që u zhvillua të shtunën e kaluar, 12.05.2019, në orën 17.00 në stadiumin e Visokos skuadra e futbollit Qendra mundi atë të Gjimnazit me rezultatin 3 – 1. Kjo ishte fitorja e parë e vendasve dhe golat u shënuan nga Osmanoviç dhe Periç.

## Shkruajeni vetë lajmin tuaj

Në një fazë të mëpasme mund të ofroni tema ose tituj teksti zbavitës, duke kërkuar prej nxënësve që në çift ose në grupe me pak vetë ta hartojnë ata vetë lajmin, duke iu përgjigjur

të gjitha pyetjeve. Së bashku me tekstin duhet të mendojnë edhe për titullin e shkrimit, i cili duhet të jetë i kuptueshëm, interesant dhe të përmbajë lajmin që përcjell tekstin.



Ja disa tema të mundshme/çështje për të shkruar një lajm:

- Elefanti ia mbathi nga kopshti zoologjik
- Fëmijët mbollën pemë
- Ra dëborë e madhe
- U mbajt gara me varka në lumë
- U zhvillua premiera e shfaqjes së filmit më të ri për fëmijë

Kërkojuni fëmijëve t'i lexojnë lajmet e shkruara prej tyre dhe bashkë me ta verifikoni nëse iu

janë përgjigjur ose jo pyetjeve të nevojshme.

## Përmirësojeni lajmin tuaj

Si mund të shkruhet sa më mirë lajmi ose artikulli juaj? Çfarë duhet bërë?

Fjala vjen, mund të:



Intervistoni njerëzit që janë të lidhur me ngjarjen ose t'i citoni (parafrazoni – përmendni) deklaratat e tyre

Të ofroni mendime të ndryshme rreth temës, duke cituar burime

Të mblidhni e ofroni sa më shumë detaje, informacione, të dhëna, mendime

Të përshkruani atmosferën, vendin e punës, reagimin e njerëzve etj.

Të shtoni fakte interesante ose të jashtëzakonshme, si dhe informacione

Në qoftë se keni mjaft kohë në dispozicion për punoni së bashku me nxënësit ndonjë prej lajmeve të shkruar prej tyre, duke shtuar

dhe pasuruar me mendime, intervista të hamendësuar, përshkrime, të dhëna, etj.

# Përse faktet janë të rëndësishëm?

Është shumë e rëndësishme që gazetari të përcjellë informacione të vërteta e të sakta; me fjalë të tjera që teksti i tij të përmbajë fakte.

## Ku ndryshojnë faktet nga opinionet?

Përse është e rëndësishme të dallohen faktet nga mendimet ose hamendësimet e dikujt kur shkruajmë (ose lexojmë) lajmin dhe/ose artikullin?



**FAKTI** është diçka e vërtetë, diçka që mund të **dëftohet, të verifikohet përmes të dhënave.**

**Mendimi (opinion)** është diçka që bazohet mbi **besimet ose ndjenjat personale të dikujt.**

**Shembull:** Pranvera

**Fakti:** Pranvera është ajo stinë e vitit që fillon më 21. 03

**Opinion:** Pranvera është stina më e bukur e vitit.

**Shembull:** lepur

**Fakti:** Lepuri është barngrënës

**Opinion:** Lepuri është i këndshëm dhe mund të zbavitësh duke luajtur.

**Hamendje:** Lepuri mund të shkatërrojë lakrat që kemi mbjellë.

Hidhini një sy lajmit që keni shkruar – cila pjesë e tij bazohet mbi faktet dhe cila mbi mendimet e dikujt tjetër (ose tuajat)?

- A mund të verifikohen të dhënat e sjella në të?
- A është i besueshëm burimi i të dhënave që keni shfrytëzuar?
- A i keni përcjellë saktë burimet e informacionit dhe emrat?
- A janë me peshë (relevante) për lajmin të dhënat?

Me nxënës më të rritur mund të bisedohet për tema më komplekse:

- Ka dalë një artikull që përmban të pavërteta. Nga e dini këtë gjë? Çfarë mund të bëni?
- Kodi etik i gazetarisë – pse është i rëndësishëm?

# Koha e informacioneve të pasakta dhe të gënjeshtërt (për nxënës të rritur)

Duke qenë se fëmijët bombardohen përditë me informacione, lajme, materiale video dhe gjëra të ngjashme është e rëndësishme që me fëmijët të hapet e të trajtohet edhe tema e lajmeve të rreme dhe e informacioneve të pasakta, të cilat iu ofrohen si të sakta e të vërteta. Ndryshe nga pjesa më e madhe e gazetarëve, të cilët, para së gjithash, e njohin mirë punën e tyre dhe e respektojnë kodin e gazetarit, për një të mirë të atyre njerëzve që prodhojnë përmbajtje mediatike rregullat e mësipërme nuk vlejnë. Me këtë nuk duam të themi se është gazetar i mirë vetëm ai që ka studiuar për t'u bërë i tillë, por respektimi i disa rregullave të caktuara është i domosdoshëm. Pyetini fëmijët t'iu thonë se cilat prej mediave bashkëkohore ata konsumojnë


më shumë. Ka të ngjarë që t'iu përgjigjen Youtube dhe rrjetet sociale, atje ku fëmijët dhe adoleshentët kalojnë pjesën më të madhe të kohës. Bisedoni me fëmijët dhe tregojuni se çfarë mekanizmash duhet të zhvillojmë në mënyrë që të bëhemi konsumatorë të mirë dhe jo t'u „besojnë verbtazi“ informacione të pasakta e të rreme, të cilat, shpesh, mund t'iu shkaktojnë dëme serioze njerëzve të caktuar ose ngjarjeve të caktuara. Kur bashkë me fëmijët të mbërrini te fakti se duhen verifikuar burimet, autorët, nënshkrimet e impressum, faktet, opinionet dhe gjithçka tjetër që përmendëm, atëherë nxënësit mund të mblidhen në grupe e të përgatisin recetën për të shfrytëzuar me mençuri mediat. Në një fletë të madhe shkruani titullin:



## PESË KËSHILLA PËR TË MOS U BESUAR VERBTAZI INFORMACIONEVE TË RREME 😊

Si veprimtari zbavitëse mund t'iu jepni fotografi (fotografia duhet të shprehë veprim dhe duke qenë se punojmë me fëmijë bëni kujdes lidhur me fotografitë që përzgjidhni) me të cilat duhet të veproni si më poshtë:

- Titull nga perspektiva të ndryshme
- Titujt duhet të jenë sensacionalë, të njëanshëm dhe, mundësisht, të gënjeshtërt



Ilustrimi: Hana Kevil

Për shembull:

Nga perspektiva e qenit: Ia mbatha nga njerëzit. Madje me not.

Nga perspektiva e njerëzve: Qeni rrëmbeu degën dhe nuk do të na e kthejë.

Në fund shpjegojuni fëmijëve që ishte vetëm një përpjekje për të shpëtur një qen.

Por, sigurisht, mund të gjeni edhe shembuj të tjerë.

# Intervista

Fillojeni duke iu kërkuar fëmijëve të mendojnë për një personalitet që e adhurojnë dhe, për të cilin, kanë mjaftueshëm njohuri. Këtu mund të hyjnë pjesëtarë të familjes, miq, por edhe aktorë/aktore, sportistë/sportiste, muzikantë/muzikante ose ndonjë personazh filmi ose veprë letrare. Përfytyroni sikur iu është dhënë rasti që ta intervistoni. Çfarë pyetjesh do t'i bënit?

Iu kërkon fëmijëve të hartojnë një listë pyetjesh të mundshme për intervistën.

- Emri i personit
- Pyetjet që dëshironi t'i bëni atij/asaj:

Në qoftë se keni kohë në dispozicion nxënësit mund të interpretojnë një intervistë të hamendësuar, duke e vënë veten në rolin e gazetarit/gazetares dhe të personazhit të trilluar. Diskutoni rreth pyetjeve që kanë menduar të bëjnë nxënësit. Cilat janë pyetjet që iu pëlqejnë të bëjnë më shumë? Pse? Cilat janë pyetjet më të mira për t'u bërë gjatë një interviste?



Përmendjuni se cilat janë disa prej karakteristikave më të rëndësishme për të bërë një intervistë të mirë:

- Pyesni për gjëra me peshë – gjëra që e nxisin tjetrin të mendojë dhe/ose e ndihmojnë.
- Pyetja të lerë gjithmonë hapësirë për më tej (përkundër atyre pyetjeve që mund t'iu përgjigjesh me po ose jo, ose me një fjalë të vetme).
- Bëni pyetje me vazhdim – pra, pyetje sqaruese për ta nxitur të intervistuarin që të përgjigjet sa më mirë.
- **DËGJONI ME VËMENDJE**, jepini të kuptojë personit që intervistoni se jeni i interesuar dhe i vëmendshëm ndaj tij.

## Lojë me pyetjet

Përgatisni disa letra me po aq pyetje sa nxënës keni. Ofrojini çdonjërit prej nxënësve të tërheqë një fije letre. Duke ecur nëpër klasë nxënësit i afrohen njëri-tjetrit në çift dhe bëjnë pyetje. Shkëmbejnë letrat me pyetjen dhe i afrohen dikujt tjetër. Në qoftë se nuk keni kohë në

dispozicion pyetjet mund t'i shfrytëzoni gjatë ushtrimit për kryerjen e intervistës – jepuni mundësinë nxënësve në çift të intervistojnë njëri-tjetrin, ndërkohë pyetjet mund t'i tërheqin nga grumbulli i letrave ose t'i përzgjedhin nga lista.

## Pyetje për intervistë:

Cilat janë objektivat tuaj për këtë vit?

Çfarë vlerëson më shumë nga vetja tënde?

Ka ndonjë gjë që njerëzit nuk dinë rreth teje ose do të dëshiroje të dinin për ty?

Kush është njeriu që ka ndikuar më shumë mbi ju? Më tregoni diçka për të.

Ajo çka mësojmë nga dështimet mund të jetë shumë e rëndësishme për sukseset e mëpasme. Mund të më thuash çfarë keni mësuar prej dështimeve?

Cilat janë ato probleme që i keni zgjidhur me sukses ose dëshironi t'i zgjidhni?

Mendoni që kjo është një shkollë e mirë – në rast se po, përse?

Kush prej mësuesve ka ndikuar më shumë mbi ju dhe pse?

Cilin konsideron suksesin tënd më të madh?

Cili ka qenë momenti më i lumtur në jetën tuaj?

Cila ka qenë gjëja më e vështirë që të është dashur ndonjëherë të bësh?

Kush nga farefisi yt është njeriu që ke më për zemër dhe përse?

Çfarë do të dëshiroje të thoshin një ditë miqtë e shokët për ty?

Si dëshiron të të kujtojnë mësuesit/mësueset?



# PËRFUNDIMI I VEPRIMTARISË

Një tekst i mirë na detyron të mendojmë gjatë për të mbasi e lexojmë. Gjithashtu shtron pyetje të reja ose na nxit të veprojmë. Pjesa përfundimtare e një veprimtarie me fëmijët luan të njëjtin rol. Në këtë fazë i ndihmojmë që vetëm të përmbledhin atë që kanë mësuar, ta lidhin me diçka jashtë kontekstit konkret të të nxënit, ta vënë në jetë duke krijuar një vlerë të re.

Në fund mund të diskutoni me fëmijët rreth asaj që kanë përvetësuar:

- Do të lexojnë tani më shumë lajme e artikuj të tjerë nga gazetatat, si dhe mendojnë se do t'i shohin me një sy ndryshe krahasuar me më parë?
- A janë të interesuar të fillojnë revistën e tyre apo t'iu afrohen redaksive të gazetave?

- Ndoshta dëshironi që tekstet dhe artikujt tuaj të botohen (ofrojuni ide nxënësve se si e ku mund t'i dërgojnë punimet e tyre ose çfarë duhet të bëjnë për të nisur një blog).
- Çfarë ishte gjëja më interesante pas kësaj përvoje për ta?
- Çfarë mesazhi do të dëshironin t'iu përcillnin gazetarëve?

Pas orës së mësimi, mbasi të kthehen në shtëpi, ndoshta mund të shkruajnë një lajm rreth vizitës suaj në shkollë, t'ua dërgojnë juve ose gazetës së shkollë. Nga ana tjetër mund të marrin një informacion shtesë nga ana juaj ose të intervistojnë pjesëtarë të familjes, fqinjë dhe persona që jepen pas një profesioni që atyre iu ngjall interes etj.

# KODI I ETIKËS SË GAZETARIT: NJË PËRMBLEDHJE \*

Kodi i etikës së mediave shqiptare është një kornizë vetërregulluese që synon rritjen e cilësisë së gazetarisë dhe të përgjegjësisë së ushtrimit të profesionit të gazetarit në Shqipëri.

## 1. Saktësia dhe paanshmëria e dhënies së informacionit

Gazetarët kanë të drejtë të marrin informacion, ta botojnë atë dhe të kritikojnë. Informacioni duhet jetë i saktë, i balancuar dhe i verifikuar.

### *Saktësia*

Gazetari duhet ta verifikojë informacionin para botimit në mënyrë që ai të jetë i saktë dhe i besueshëm. Procesit të verifikimit duhet t'i nënshtrohen të gjitha faktet: qoftë ato të mbështetura në burime njerëzore, qoftë në dokumente të ndryshme.

### *Paanshmëria.*

Informacioni konsiderohet i paanshëm kur gazetari u referohet të gjitha burimeve që kanë informacion apo janë protagonistë të ngjarjes.

## 2. Dallimi i fakteve nga opinionet

Gazetari duhet të dallojë qartësisht faktet nga opinionet. Lajmi nënkupton informacion të përbërë nga faktet dhe të dhënat, ndërsa opinioni përmban ide, gjykime dhe vlerësime nga ana e gazetareve, redaktorëve dhe botuesve.

## 3. Korrektimi dhe Replika

Në rastin e botimit të pasaktësive apo shpifjeve media duhet të bëjë një korrigjim të qartë publik dhe në vend të dukshëm, ku të tregohet se informacioni i pasaktë ose i shtrembëruar është bërë publik, dhe nëse është e nevojshme të kërkojë ndjesë.

## 4. Marrëdhënia me burimet

Gazetarët duhet të bëjnë çdo përpjekje për të mbledhur informacion nga të gjitha burimet e mundshme, në mënyrë që të garantojnë që informacioni është i saktë, i plotë dhe i paanshëm. Informacioni duhet të mblidhet në mënyrë etike dhe ligjore. Personi që intervistohet duhet të ketë të drejtën të dijë nga cila media dhe në çfarë konteksti do të përdoren prononcimet e tij.

\* Kodi i Etikës së Gazetarit është hartuar dhe propozuar nga një grup ekspertësh shqiptarë, me ndihmën e konsulencës së huaj. Kodi është paraqitur për diskutim me gazetarë, organizata mediash dhe ekspertë të medias në vitin 2018, duke reflektuar sugjerimet përkatëse. Duke qenë se në Shqipëri ende mungojnë mekanizmat e konsoliduara vetërregulluese, respektimi i Kodit mbetet në vullnetin e gazetarëve dhe redaksive. Hartimi i Kodit u koordinua nga Instituti Shqiptar i Medias dhe Këshilli Shqiptar i Medias dhe u bë i mundur me mbështetjen e një projekti të përbashkët të Bashkimit Europian dhe Këshillit të Europës.

## 5. Pavarësia editoriale

Stafi editorial nuk duhet të lejojë që nxitjet/ interesat personale, politike apo financiare të ndikojnë në raportimin e tyre të saktë dhe të paanshëm. Stafi editorial do t'i rezistojë kërcënimeve/nxitjeve/joshjeve për ndikuar, shtrembëruar apo fshehur informacionin dhe nuk do të përfitojë personalisht për shkak të informacionit/materialeve të përfituara gjatë punës se tij për të bërë publik informacionet.

## 6. Marrëveshja para publikimit

Gazetarët që bien dakord për të mos botuar një material, për një periudhë të caktuar, duhet t'i qëndrojnë marrëveshjes deri në momentin e skadimit të marrëveshjes. Marrëveshja (embargo) mund të shkelet nëse materiali ndërkohë botohet gjetkë, ose personi që ka kërkuar "kohë", e shkel vetë afatin apo nuk i përmbahet marrëveshjes së arritur.

## 7. Përgjegjësia pas botimit

Redaksia është përgjegjëse për botimin e artikujve pa autorësi apo me pseudonime, të letrave të lexuesve, komenteve dhe përgjigjeve në web-sitin e medias. Është e rekomandueshme që redaksia të botojë/ të bëjë të qartë, termat dhe kushtet për zgjedhjen dhe botimin e përgjigjeve.

## 8. Gjuha e urrejtjes.

Media nuk duhet të botojë materiale që ofendojnë apo nxisin urrejtje ndaj individit bazuar në racën, fenë, kombësinë, ngjyrën, origjinën etnike, anëtarësinë, gjininë, orientimin seksual, gjendjen civile, aftësinë/paafësinë, sëmundjen apo moshën.

## 9. Ndërhyrja në jetën private të njerëzve

Gazetarët duhet të respektojnë nderin dhe reputacionin e individëve që bëhen

objekte të interesit të tyre profesional. Çdo informacion i pasaktë që dëmton në mënyrë të qëllimshme apo të paqëllimshme imazhin e tjetrit përbën cenim të dinjitetit njerëzor.

## 10. Konflikti i interesit

Stafi editorial nuk duhet të përfitojë personalisht për shkak të informacionit/materialeve të siguruara nga media e tyre. As pronarët dhe as gazetarët nuk duhet të përdorin informacionin profesional për asnjë qëllim tjetër përveç informimit të publikut.

## 11. Nxitja e krimit dhe dhunës

Produktet mediatike që propagandojnë luftë, dhunë, zemëratë, apo lëndojnë ndjenjat e gjithë publikut janë rreptësisht të ndaluara.

## 12. Raportimi i aksidenteve dhe fatkeqësive

Gazetarët duhet të respektojnë të drejtën e njerëzve për të mbajtur zi dhe duhet t'i raportojnë këto tema duke treguar simpati dhe vetëpërmbajtje. Në rast aksidentesh dhe fatkeqësish, gazetari duhet të respektojë vuajtjet e viktimave dhe ndjenjat e familjeve të tyre.

## 13. Raportimi i çështjeve gjyqësore dhe prezumimi i pafajësisë

Raportimet nga gjykata (përfshirë dhe përdorimin e imazheve/pamjeve filmike, duhet të jenë të sakta, të ndershme dhe jo paragjyquese ndaj të drejtës për një gjyq të drejtë. Gazetarët duhet të respektojnë gjithnjë parimin juridik të prezumimit të pafajësisë dhe nuk duhet ta përshkruajnë dikë si kriminel para se ky të shpallet fajtor nga gjykata me vendim të formës së prerë.

#### **14. Mbrojtja e fëmijëve dhe njerëzve me aftësi të kufizuara**

Gazetari duhet të respektojë të gjitha parimet e konfirmuara në Konventën e OKB-së të vitit 1989 mbi të drejtat e fëmijëve, si dhe legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e fëmijëve. Gazetari mbron të drejtat dhe dinjitetin e fëmijëve dhe njerëzve me aftësi të kufizuara, përfshirë dhe të drejtën e tyre për t'u dëgjuar.

#### **15. E drejta e autorit**

Gazetarët duhet të respektojnë dhe të kërkojnë respektimin nga të tjerët të së drejtës të autorit. Plagjiatura është e papranueshme.

#### **16. Marrëdhëniet mes gazetarëve**

Në punën e tyre, gazetarët duhet të ruajnë balancën mes konkurrencës së ndershme dhe solidaritetit profesional.

#### **17. Interesi publik**

Shkelja e termave të këtij Kodi mund të përlligjet vetëm kur mund të tregohet qartë që kjo është në shërbim të interesit publik.

Interesi publik përkufizohet si më poshtë:

- Mbrojtja e shëndetit të publikut dhe sigurisë së tij;
- Gjetja, ekspozimi, ose parandalimi i një krimi, skandali, apo shpërdorimi me pushtetin;
- Mbrojtja e publikut nga çorientimi.

#### **18. Gjuha shqipe**

Gazetarët duhet të zbatojnë me kujdes rregullat e gjuhës shqipe dhe të shmangin përdorimin e fjalëve të huaja kur kjo është e mundur.

# Rreth autorëve

**Radmila Rangelov Jusovic**, Doktore Shkencash në arsim, është drejtore ekzekutive e Qendrës për Nisma Arsimore Step by Step, një organizatë profesionale, jo-qeveritare që ndërmerr dhe kujdeset për nisma që ndryshojnë sistemin arsimor në Bosnjë-Hercegovinë. Nën udhëheqjen e saj në 20 vitet e fundit, Qendra është kthyer në një nga organizatat profesionale më të njohura dhe të respektuara, duke aktivizuar në aktivitetet e tyre më shumë se 10.000 arsimtarë.

Si specialiste arsimit, Radmila punon në Bosnjë dhe në vende të tjera si konsulente, trajnere dhe zhvilluese programesh në fusha të ndryshme të lidhura me cilësinë në arsim, standardet e cilësisë, zhvillimi shkollor, trajnimi i mësuesve, etj. Ajo është autore dhe bashkë-autore e më shumë se 20 librave dhe manualeve për mësuesit, si dhe e programeve të trajnimit.

**Nedim Krajišnik**, kandidat për Doktor Shkencash në shkenca politike, dhe Zëvendës Drejtor i CEI Step by Step. Nedim ka qenë aktivist për rininë që në moshë të re. Ai është një nga themeluesit e Shoqatës së nxënësve të shkollave të mesme në Bosnjë-Hercegovinë dhe bashkëautor i politikave dhe strategjive të shumta për rininë. Nedim ka më shumë se 15 vite përvojë si trajner në vend dhe jashtë. Ka qenë i përfshirë në analizat e politikave të arsimit, por edhe në zhvillimin e programeve të ndryshme të trajnimit në fushat e arsimit, drejtësisë sociale, mendimit kritik.

**Media për Qytetarët – Qytetarët për Median** është një projekt i shtatë organizatave për zhvillimin e medias (*Fondacioni “Mediacentar”, Instituti Shqiptar i Medias, Instituti Maqedonas për Median, Instituti Malazez i Medias, Shkolla e Gazetarisë në Novi Sad, Instituti i Paqes, SEENPM*) në Ballkanin Perëndimor, i cili ka për qëllim të ndërtojë kapacitetin e organizatave të shoqërisë civile në rajon për të të zhvilluar aftësitë dhe kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile për të nxitur dhe mbështetur edukimin për median dhe informacionin (EMI.)

**“Media për Qytetarët – Qytetarët për Median”**

[www.seenpm.org](http://www.seenpm.org)

<https://www.facebook.com/seenpm.org/>

@SEENPM\_org

[www.cimusee.org](http://www.cimusee.org)

<https://www.facebook.com/CIMUSEE/>

@CIMU\_SEE

Për më shumë informacion rreth projektit ju lutem kontaktoni në **admin@seenpm.org** ose **info@institutemedia.org**



Titulli: Udhëzues për Gazetarët: Për edukimin në fushën e medias dhe informacionit

Botues: Instituti Shqiptar i Medias  
Rr. Gjin Bue Shpata, No.8, Tiranë, Albania  
Tel./fax: ++ 355 4 2229800  
E-mail: info@institutemedia.org  
www.institutemedia.org

Autorë: Nedim Krajišnik dhe Dr. Radmila Rangelov Jusović

Përkthyes: Virgjil Muçi

Korrektor: Artan Puto

Konceptimi grafik: Slaviša Starčev

ISBN 978-9928-307-21-7

Faqosja: Bujar Karoshi, M&B Botime dhe Studio Grafike

Tirazhi: 30

Printuar: M&B Botime dhe Studio Grafike

---

#### CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Rangelov-Jusović, Radmila  
Udhëzues për gazetarët : për edukimin në fushën e medias dhe informacionit / Radmila Rangelov-Jusović, Nedim Krajišnik ; përkth. Virgjil Muçi. – Tiranë : M & B, 2020  
24 f. ; 21x29.5 cm.  
Tit. origj. : Priručnik za novinare iz oblasti medijske i informacijske pismenosti

ISBN 978-9928-307-21-7

I. Krajišnik, Nedim

1.Gazetaria 2.Gazetarë 3.Etika e gazetarisë 4.Udhëzues

070.422 (035)

---



Ky dokument është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e partnerëve të projektit Media për Qytetarët- Qytetarët për Median dhe nuk duhet konsideruar në asnjë mënyrë si pasqyrim i pozicionit të Bashkimit Evropian.



MEDIA PËR  
QYTETARËT  
QYTETARËT  
PËR MEDIAN



Financuar nga  
Bashkimi Europian

ISBN 978-9928-307-21-7



9 789928 307217 >